



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 66, datë 10.04.2025

PËR

**“SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 307, DATË 21.11.2022, “PËR PEZULLIMIN E
PROCEDIMIT DISIPLINOR TË FILLUAR NDAJ MAGJISTRATIT ERIND
REOVICA, ME DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË FIER””**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 10.04.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 dhe vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:



“Shfuqizimin e Vendimit nr. 307, datë 21.11.2022 “Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Erind Reovica, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier””

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 1105 prot., datë 02.04.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zotin Vatë Staka, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, ndër të tjera rregullon zhvillimin e procedurave për procedimin disiplinor ndaj magjistratëve.
3. Me shkresën nr. 117/6 prot., datë 24.10.2022 *“Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Erind Reovica, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”*, Inspektori i Lartë të Drejtësisë (në vijim Inspektori) ka propozuar caktimin ndaj magjistratit Erind Reovica, të masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”*, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” dhe “dh”, të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar.
4. Ndaj magjistratit Erind Reovica ka pasur edhe një tjetër proces administrativ, të filluar sipas ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Në përfundim të këtij procesi administrativ me vendimin nr.508, datë 10.02.2022, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim KPK) ka vendosur shkarkimin nga detyra të prokurorit. Ndaj këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit Erind Reovica ka paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim KPA), ku është regjistruar çështja (JR) nr. 18/2022, datë 12.04.2022.
5. Në përputhje me pikën 6, të nenit F, të Aneksit *“Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, të Kushtetutës prokurori kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra, deri në marrjen e vendimit nga Kolegji i Posaçëm të Apelit.
6. Këshilli, referuar përcaktimeve ligjore të neneve 126 dhe 145 të ligjit nr. 96/2016 *“Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, si dhe



nenit 66, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar*, ka konsideruar se është në kushtet e pezullimit të procedimit disiplinor të filluar nga Inspektori, deri në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, duke vlerësuar se “mbajtja” ose “jo” e statusit të magjistratit nga prokurori Erind Reovica, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor të Inspektorit, të filluar ndaj tij.

7. Në këtë kontekst, si dhe në zbatim të dispozitës Kushtetuese cituar në pikën 5 të këtij akti, Këshilli ka marrë vendim nr. 307 datë 21.11.2022, *“Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Erind Reovica, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”*, duke pezulluar procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratit, deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.
8. Pas shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit nr. 508, datë 10.02.2022, të KPK-së, Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr. 23, datë 18.03.2025 ka vendosur *lënien në fuqi* të vendimit objekt ankimi. Ky vendim i është komunikuar zyrtarisht Këshillit me shkresën nr. 296/13 prot., datë 18.03.2025, me lëndë *“Dërgim vendimi me arsyetim të përmbledhur”* (administruar në institucion me nr. 1018 prot., datë 20.03.2025).
9. Sipas pikën 5, të nenit F, të Aneksit *“Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, të Kushtetutës, vendimi përfundimtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit që urdhëron shkarkimin ka afekt të menjëhershëm, hyn në fuqi menjëherë dhe sjell mbarimin e statusit të magjistratit.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

10. Pas vendimit nr. 23 datë 18.03.2025, të Kolegjit të Posaçëm i Apelimit, shkak ligjor i pezullimit të procedimit disiplinor i konsideruar nga Këshilli në vendimin e tij nr. 307, datë 21.11.2022, *“Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Erind Reovica, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”*, ka rënë dhe nuk ekziston më.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, shkronjat “b” dhe “e”, të Kushtetutës, nenet 164, pika 8, 166, 189, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar*, si dhe nenet 66, 67 dhe 68, pika 2 të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar*,

V E N D O S I:



1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 307 dt. 21.11.2022, "Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit Erind Reovica, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier".
2. Vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit Erind Reovica.
3. Një kopje e vendimit t'i njoftohet ish-magjistratit Erind Reovica dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 10.04.2025



KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla